

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës

Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2022

Në bazë të Pjesës së Projekt-procesverbalit të seancës së pesëdhjetë e pesë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, pika e 45-të, e mbajtur më 28 qershor 2022, a në lidhje me Planin vjetor të vlerësimit të rreziqeve nga korrupsioni, në pajtim me Raportin e GREKO-së (rrethi i pestë i vlerësimit), a në lidhje me Rekomandimin 11, ku të gjitha organet e administratës shtetërore ishin të angazhuara në afat prej 15 ditësh të miratojnë plan vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni për vitin 2022, sipas kompetencave të tyre, a në lidhje me nenin 27 paragrafin 5 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe nenin 6 të Statutit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, Kryetari i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, miratoi

Plan vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2022

Me Korrupsion nënkuptohet keqpërdorimi i funksionit, detyrës apo pozitës zyrtare për përfitime, drejtpërdrejt ose nëpërmjet ndërmjetësuesit, për veten ose për person të tretë.

Nocioni i korrupsionit përfshinë:

- Korrupsioni pasiv - veprim i qëllimshëm i personit zyrtar i cili, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, kërkon ose merr përfitime të çdo lloji, për vete ose për palë të tretë, ose pranon një premtim për një përfitim të tillë në mënyrë që të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në pajtim me detyrimet e tij ose të ushtrojë kompetencat e tij në kundërshtim me detyrat e tij zyrtare, dhe
- Korrupsioni aktiv - veprim i qëllimshëm mbi çdo person që drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, premtion ose përfiton nga çdo lloj zyrtari, për të ose për palë të tretë, me qëllim që të veprojë ose të përmbahet nga të vepruarit në pajtim me detyrat e tij/saj ose të kryejë kompetencat e tij/saj në kundërshtim me detyrat e tij/saj zyrtare.
- Me konflikt të interesave nënkuptohet gjendja në të cilën personi zyrtar ka interes privat që ndikon ose mund të ndikojë mbi kryerje të paanshme të autorizimeve të tij publike ose detyrave zyrtare.

Duke u nisur nga fakti që korrupsioni i rrezikon të drejtat që u takojnë qytetarëve, i deregjon ligjet dhe e pamundëson drejtësinë, e varfëron shoqërinë, e dëmton shtetin juridik, është e domosdoshme që lufta kundër kësaj të keqe të jetë obligim i përhershëm i çdo të punësuarit.

Me qëllim të funksionimit të suksesshëm të të gjitha aspekteve të punës së Komisionit, është e domosdoshme të gjendet një mënyrë e përshtatshme dhe efikase për tu ballafaquar me korrupsionin. Për këtë arsye, nevojitet një luftë e pa kompromis dhe pa dallim kundër sjelljeve korruptive.

Qëllimi i planit për parandalimin e korrupsionit në Komision është para së gjithash përforcimi i integritetit personal dhe profesional të punonjësve për të kundërshtuar në mënyrë efektive korrupsionin, konfliktin e interesave, si dhe kryerjen e punës në mënyrë ligjore, të pavarur, të paanshme, etike, të përgjegjshme dhe transparente, në mënyrë që punonjësit të ruajnë reputacionin e tyre dhe të Komisionit.

Komisioni synon të vendos integritet individual të punonjësve, që nënkupton një qëndrim personal ndaj çështjeve të korrupsionit, konfliktit të interesave, interesit publik dhe aftësisë për të ndërtuar qëndrueshmëri si mënyrën e tij të punës, si dhe llogaridhënie, profesionalizëm dhe korrektësi në kryerjen e kompetencave të përcaktuara me rregulloret dhe aktet ligjore pozitive të Komisionit.

Komisioni synon të vendos integritet institucional, që tregon rezistencë ndaj korrupsionit dhe nënkupton një sistem të vendosur politikash, standardesh, mekanizmash dhe procedurash që ulin rrezikun e sjelljeve korruptive nga ana e punonjësve, duke propozuar masat e duhura për mënjanim dhe njëkohësisht i motivon ata për qëndrim të ndershëm dhe profesional gjatë kryerjes së detyrave të tyre zyrtare në përputhje me rregullat, rregulloret, standardet profesionale dhe kodin etik të sjelljes.

Detyra kryesore e Komisionit do të jetë njohja në kohë e rreziqeve të korrupsionit, propozimi i masave të duhura për eliminimin e tyre dhe sanksionimi i autorëve. Komisioni në mënyrë afatgjatë parandaluese dhe represive, do t'i aftësojë dhe forcojë kapacitetet normative, institucionale dhe personale për luftë efikase kundër korrupsionit, do të zhvillojë mekanizma për zvogëlimin e rreziqeve të korrupsionit dhe do të ketë zero tolerancë ndaj korrupsionit.

Në kuadër të parandalimit, do të fokusohet në zvogëlimin e mundësive dhe krijimin e kushteve të pafavorshme për kryerjen e veprave korruptive, dhe për një luftë efektive kundër të njëjtit duhet të ketë vullnet politik, zgjidhje normative, zbatim efikas të ligjeve, institucionalitet dhe kapacitet dhe integritet personal.

Askush nuk duhet të përjashtohet në përcaktimin e përgjegjësisë për sjellje korruptive, pasi askush nuk ka mandat të pengojë, kufizojë ose në çfarëdo mënyre zbeh procesin e përcaktimit të përgjegjësisë.

Me planin vjetor përcaktohen fushat ku më së shpeshti ekziston rreziku i korrupsionit, edhe atë:

- gjatë procedurave të punësimit, përzgjedhjes dhe avancimit;
- gjatë procedurave të furnizimit publik;
- gjatë procedurave të vlerësimit të përqendrimit;

- gjatë udhëheqjes së procedurës për kundërvajtje (fillimi, udhëheqja, përfundimi dhe përcaktimi i masës së gjobës) dhe

- gjatë procedurave të miratimit të dhënies së ndihmës shtetërore.

Format e korrupsionit detektohen nëpërmjet:

- keqpërdorimit të detyrës ose pozitës zyrtare për përfitime, drejtpërdrejt ose nëpërmjet një ndërmjetësi, për veten ose për një palë të tretë,

- duke vepruar ose mos vepruar gjatë kryerjes së detyrave dhe autorizimeve zyrtare,

- mosrespektimit të procedurave standarde.

Në kontekst të asaj që u tha më sipër, synimet parësore për vitin 2022 do të jenë: përforcimi i integritetit të punonjësve, respektimi i kodit të nëpunësve administrativë, bashkëpunimi ndër-institucional në luftën kundër korrupsionit, zbatimi i vlerësimit për rrezikun e paraqitjes së korrupsionit në vendet e punës, miratimi i procedurave të përcaktuara, profesionalizimi, departizimi dhe depolitizimi i punonjësve, trajnimi i vazhdueshëm dhe i specializuar, përforcimi i besimit të qytetarëve për denoncimin e korrupsionit, përforcimi i kontrollit të furnizimeve publike, përforcimi i parimeve të llogaridhënies dhe transparencës në funksionimin e Komisionit.

Masat e propozuara për parandalimin e korrupsionit:

- Respektimi i kushtetutës dhe ligjeve, respektimi i politikës së antikorrupsionit dhe i politikës së integritetit, procedurat dhe rregullat e brendshme për trajtimin e rasteve nga të gjitha fushat e funksionimit, respektimi i afateve për zgjidhjen e rasteve që janë në kompetencë të Komisionit, sjellje të ndërgjegjshme, profesionale dhe të përgjegjshme, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie gjatë punës, duke mundësuar qasje të lirë në informacione me karakter publik, respektimi i disiplinës financiare, duke caktuar një person për parregullsi, dyshime, mashtrime dhe korrupsion, paraqitje të detyrueshëm të sjelljeve korruptive, të palejueshme, të paligjshme dhe jo etike të personave zyrtarë, duke marrë masa disiplinore ndaj personave që sillen në mënyrë korruptive, të palejueshme, të paligjshme dhe jo etike.

Për realizimin e aktiviteteve të planifikuara dhe zbatimin e masave të propozuara, të gjitha sektorët në Komision janë kompetentë. Plani vjetor për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës për vitin 2022.

Komisioni për mbrojtjen e Konkurrencës

Kryetar

Prof. Dr. Владимир Наумовски

